



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ prot.
më _____.____.2020

Elbasan,

LËNDA: Dërgim njoftimi për botim në Buletinin e Prokurimit Publik.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan

Për: **“Flamur Asllani” p.f.** me adresë: Lagjja "Dyli Haxhire", bulevardi "Aqif Pasha", pall.
nr. 10/1, kati 1, Elbasan.

Procedura e prokurimit: Kërkesë për Propozim – Marrëveshje Kuadër.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Loti IV : “Blerje mish për Shtëpinë e të Moshuarve” - Marrëveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj, me fond limit **541,210** (pesëqind e dyzet e njëmijë e dyqind e dhjetë) **lekë pa t.v.sh.**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2020 dhe 2021. Ky fond përbën vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër. Shumatorja e çmimeve për njësi: **2,333** (dymijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë pa tvsh.**

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF- 67925-08-06-2020

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “Zamira Qazimi” p.f. me Nipt: K 52628202 V

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është **2,324** (dymijë e treqind e njëzet e katër) **lekë** (pa tvsh).

2. “Flamur Asllani” p.f. me Nipt: L 62602209 S

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është **2,320** (dymijë e treqind e njëzet) **lekë** (pa tvsh).

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Ofertuesi “Zamira Qazimi” p.f. me Nipt: K 52628202 V

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Ofertuesi “Zamira Qazimi” p.f. skualifikohet për arsye se: Ky operator ekonomik kishte mangësi në dokumentacionin e paraqitur e konkretisht:

1. Në pikën 2.3, pika 6 të Kapacitetit Teknik të DST kërkohet: Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- **ISO 22000:2018** “Çertifikatë e sistemit të menaxhimit të sigurisë ushqimore ose ekuivalente me to.

Operatori ekonomik, në përmbushje të këtij kriteri nuk e ka paraqitur çertifikatën e kërkuar.

2. Në pikën 2.3, pika 5 të Kapacitetit Teknik të DST kërkohet: Operatori ekonomik duhet të **disponojë një automjet** të përshtatshëm ATV frigoriferik (minimumi i kapacitetit mbajtës është 500 kg) për transportin e mallrave objekt prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm:

- **Akti e pronësisë së mjetit përkatës ose Kontratën e marrjes me qira të mjetit**, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qerasë të jetë noteriale.
- **Lejen higjieno-sanitare të mjetit të vlefshme** të lëshuar nga organet kompetente të Ministrisë së Shëndetësisë në rrethet përkatëse (Inspektoriati që mbulon fushën e shëndetit).

3. Oferta ekonomike e paraqitur nga OE në bazë të përlllogaritjeve të çmimeve për njësi të ofertuara, me sasinë e kërkuar sipas preventivit në DST, rezulton me vlere totale më të larte se fondi limit i prokuruar nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur kontratën e marrjes me qira të automjetit e lidhur me qiradhënësin Julian Sinani në datën 29.03.2017 për një afat kohor 2-vjeçar. Kjo kontratë konsiderohet e pavlefshme pasi i ka përfunduar afati kohor, duke mos përmbushur kështu kriterin e mësipërm.

Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit,

duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...]

“ Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

Sa mësipër, komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. “Flamur Asllani” p.f. me Nipt: L 62602209 S

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është **2,320** (dymijë e treqind e njëzet) **lekë** (pa tvsh).

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë **Bashkisë Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve)**, brenda **5 (pesë)** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 18.08.2020

Ankesa: nuk ka pasur

TITULLARI I AUTORITETIT

KONTRAKTOR

PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ

ZV.KRYETARI

Irland Sina